

MELEQE KURSONI

HULUMTIMI I SUKSESIT NË LËNDËN E GJUHËS SHQIPE NË TESTET E MATURËS SHTETËRORE NË QYTETIN E GJAKOVËS

Për testet e maturës shtetërore të vitit 2015 MASHT kishte paraparë ndryshime (me qëllimin e gjetjes së zgjidhjes më të mirë të mundshme, që nxënësit mos jenë të varur nga kalueshmëria e testit shtetëror për të fituar të drejtën e regjistrimit në universitet). Mirëpo sipas të dhënave të fundit si duket edhe këtë vit nuk do ketë ndryshime në testet e maturës shtetërore. Provimi është caktuar të mbahet në afatin e Qershorit (dita e parë në 6 qershor 2015, dita e dytë në 20 qershor 2015) dhe në afatin e Gushtit (dita e parë në 29 gusht 2015, dita e dytë në 5 shtator 2015), në bazë të Ligjit Nr. 03/L-018 për Provimin Përfundimtar dhe Provimin e Maturës Shtetërore (6 nëntor 2008).

“Këtë vit, Provimi i Maturës Shtetërore do të organizohet sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara me ligjin në fuqi (Ligjit Nr. 03/L-018 për Provimin Përfundimtar dhe Provimin e Maturës Shtetërore) dhe çdo kandidat që i nënshtrohet Provimit të Maturës Shtetërore, duhet të arrijë kriterin e pragut të kalueshmërisë 50% nga rezultati i përgjithshëm i arritshmërisë së pikëve të provimit, që të shpallet i diplomuar i shkollës së mesme të lartë dhe të arrijë kushtin e përgjithshëm për të vazhduar shkollimin e mëtutjeshëm. Kandidatit që kalon Provimin e Maturës Shtetërore i jepet diploma për kryerjen e shkollës së mesme të lartë, ndërsa kandidatit që nuk arrin rezultatin e kalueshmërisë shpallet përsëritës i provimit të maturës”, thuhet në njoftimin e MASHT-it.¹

Cili është roli i gjuhës shqipe në përgjithësi dhe ai i pyetjeve të cilat planifikohen për lëndën e gjuhës shqipe në testet e maturës shtetërore?

Domosdo njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë gjuhësore që nxënësi ka grumbulluar gjatë viteve të arsimit fillor dhe të mesëm janë faktor numër një i suksesit ose mosesuksesit në arritjen e kalueshmërisë së pragut 50% i cili kërkohet nga MASHT. “Mësimi i gjuhës vazhdon për gjatë gjithë jetës, por bazat gjuhësore të mësuara në shkollë përbëjnë boshtin, i cili mëton të jetë ekuilibrimi i rregullsive gjuhësore në të folur e në të shkruar.”²

Në Traktatin e të mësuarit Vive thotë se nga gjuhët “burojnë të gjitha artet e tjera dhe disiplinat” dhe pastaj po në këtë vepër por në një vend tjetër ai shkruan: “ato janë ana e jashtme e gjitha arteve dhe disiplinave”³.

¹ wwwtelegraf.com

² I. Hoti, *Gjuhësia e zbatuar dhe mësimdhënia e gjuhës*, UT, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Studime Albanologjike, Gjuhësi I, Tiranë, 2013, f. 11.

³ J. Chateo -grup autorësh, *Pedagogët e mëdhenj*, Libra për një shoqëri të hapur, Toena, Tiranë, 200, f. 48.

Hulumtimi ynë është një vështrim i suksesit të maturantëve të qytetit të Gjakovës gjatë viteve 2011-2014 në lëndën e gjuhës shqipe. Gjedhe të hulumtimit tonë janë pesë shkollat e mesme të qytetit: Gjimnazi “Hajdar Dushi”, SHMM “Hysni Zajmi”, SHME “Kadri Kusari”, SHMT “Nexhmedin Nixha” dhe SHAP “Gjon Nikoll Kazazi”.

Në vitin 2011 në lëndën e gjuhës shqipe nxënësit duhej të përgjigjeshin në tridhjetë pyetje. Secila përgjigje e saktë vlerësohej me nga një pikë. Nga viti 2012 deri në vitin 2014 testet e maturës shtetërore u ndryshuan dhe në lëndën e gjuhës shqipe nxënësit kishin gjithsej pesëdhjetë pyetje 25% të pyetjeve të përgjithshme. Secila përgjigje e saktë vlerësohej me një pikë.

Në pyetjet e dedikuara për lëndën e gjuhës shqipe dhe letërsisë 10-12% e pyetjeve kryesisht i takonin lëmit të gjuhësisë. Më poshtë do paraqesim disa pyetje nga gjuhësia të cilat kemi mundur t'i mbledhim në disa teste të maturës shtetërore.

Folja në mënyrën lidhore haset në vargun:

- A. *Ai që ka ekzistuar para teje jam unë*
- B. *Sa më pak shikoje veten në pasqyrë*
- C. *Jetën ta jetosh pa e vrarë*
- D. *Me pleh kurr mos u pajto⁴*

Në togfjalëshin “ceremoni martesore”; fjala “martesore” është:

- A. *emër*
- B. *përemër*
- C. *ndajfolje*
- D. *mbiemër⁵*

Në strukturën “oshëtima e tyre ishte më e fuqishme”, mbiemri “më e fuqishme” është në shkallën:

- A. *pohore*
- B. *sipërore*
- C. *krahasore të sipërisë relative*
- D. *krahasore të sipërisë absolute⁶*

Rezultatet e hulumtimit

Në tabelat e mëposhtme do paraqesim analizën e suksesit në lëndën e gjuhës shqipe në testin shtetërorë të maturantëve të muajit qershor (afati i parë) i cili sipas mendimit tonë është dhe më real. Gjithashtu do paraqesim dhe suksesin e nxënësve të cilët në lëndën e gjuhës shqipe janë përgjigjur pozitivisht në më shumë se dyzet pyetje.

Në fund do paraqesim dhe një tabelë të suksesit të përgjithshëm të maturantëve.

⁴ Republika e Kosovës, MASHT, *Testi i Maturës*, Prishtinë, gusht 2008, grupi A, f. 5.


⁵ Republika e Kosovës, MASHT, *Testi i Maturës*, Prishtinë, 9 qershor 2012, grupi C, f. 3.

⁶ Po aty, f. 5.

Parimet gjuhësore dhe letrare në korpusin e programeve të gjuhës dhe letërsisë...

Analiza e suksesit të testeve të maturës shtetërore e nxënësve të Gjinnazit “Hajdar Dushi”

Muaji dhe viti	Nr. i nxënësve	Pikët e parapara	Pikët e suksesit	% kalueshmërisë
Qershor 2011	456	13680	6740	49.269
Qershor 2012	714	35700	20954	58.69
Qershor 2013	680	34000	19991	58.79
Qershor 2014	623	31150	16937	54.37




Në vitin 2012 me 40 e më shumë pikë kaluan 32 nx. Në vitin 2013 kaluan 34 nx., ndërsa në vitin 2014 vetëm 4 nx.

Analiza e suksesit të testeve të maturës shtetërore e nxënësve të SHMM “Hysni Zajmi”

Muaji dhe viti	Nr. i nxënësve	Pikët e parapara	Pikët e suksesit	% kalueshmërisë
Qershor 2011	256	7680	2701	31.169
Qershor 2012	393	19650	12918	65.74
Qershor 2013	301	15050	8499	56.47
Qershor 2014	546	27300	12558	46.00


MELEQE KURSONI



Në vitin 2012, 63 nxënës kishin mbledhur 40 e më shumë pikë. Në vitet 2013-2014 asnjë maturant nuk kishte kaluar pragun e 40 pikëve.

Analiza e suksesit të testeve të maturës shtetërore e nxënësve të SHME "Kadri Kusari"

Muaji dhe viti	Nr. i nxënësve	Pikët parapara	Pikët e suksesit	% kalueshmërisë
Qershor 2011	238	7140	2324	32.54
Qershor 2012	306	15300	9376	61.281
Qershor 2013	401	22050	91619	43.62
Qershor 2014	534	26700	10592	39.67




Parimet gjuhësore dhe letrare në korpusin e programeve të gjuhës dhe letërsisë...

Nga 50 pikët e mundshme vetëm 11 maturant të kësaj shkolle në vitin 2012 në testin e maturës shtetërore arritën të mbledhin 40 e më shumë pikë në lëndën e gjuhës shqipe.

Analiza e suksesit të testeve të maturës e nxënësve të SHMT "Nexhmedin Nixha"

Muaji dhe viti	Nr. i nxënësve	Pikët e parapara	Pikët e suksesit	% e kalueshmërisë
Qershor 2011	176	5280	1340	25.37
Qershor 2012	206	10300	4481	43.50
Qershor 2013	178	8900	3769	42.34
Qershor 2014	291	14550	4605	31.65




Në këtë shkollë vetëm një maturantë në vitin 2014 në lëndën e gjuhës shqipe kishte arrirë të përgjigjej saktë në 40 pyetje, nga 50 të cilat ishin paraparë për këtë lëndë.

Analiza e suksesit të testeve të maturës e nxënësve të SHAP "Gjon Nikoll Kazazi"

Muaji dhe viti	Nr. i nxënësve	Pikët e parapara	Pikët e suksesit	% e kalueshmërisë
Qershor 2011	106	3180	1011	31.79
Qershor 2012	173	8650	5740	66.35
Qershor 2013	86	4300	2634	61.25
Qershor 2014	181	9050	4182	46.21

MELEQE KURSONI





Gjatë viteve 2012-2013, 25 maturantë të kësaj shkolle kishin kaluar pragun e 40 e më shumë përgjigjeve të sakta.


Suksesi i përgjithshëm i nxënësve në testin e maturës shtetërore për lëndën e gjuhës shqipe në pesë shkolla të Arsimit të mesëm të lartë në qytetin e Gjakovës

Shkolla	Gjinnazi	Mjeksia	Ekonomia	Teknika	Gj.N.Kazazi	Gjithsej
Viti	2011	2011	2011	2011	2011	2011
Nxënës	456	256	238	176	106	1232
Pikët	6740	2701	2324	1340	1011	14116
%	49.268 %	35.169 %	32.54 %	25.37 %	31.79 %	38.192 %
Viti	2012	2012	2012	2012	2012	2012
Nxënës	714	393	306	206	173	1792
Pikët	20954	12918	9376	4481	5740	53469
%	58.69 %	65.74 %	61.28 %	43.50 %	66.35 %	59.675 %
Viti	2013	2013	2013	2013	2013	2013
Nxënës	680	301	401	178	86	1646
Pikët	19991	8499	9619	3769	2634	44512
%	58.79 %	56.47 %	43.62 %	42.34 %	61.25 %	54.08 %
Viti	2014	2014	2014	2014	2014	2014
Nxënës	623	546	534	291	181	2175
Pikët	16937	12558	10592	4605	4182	48874
%	54.37 %	46.00 %	39.67 %	31.65 %	46.21 %	44.94 %



Parimet gjuhësore dhe letrare në korpusin e programeve të gjuhës dhe letërsisë...



Suksesi i përgjithshëm i maturantëve sipas viteve




MELEQE KURSONI



Suksesi i përgjithshëm i maturantëve në testin e maturës shtetërore në pesë shkolla të qytetit të Gjakovës në lëndën e gjuhës shqipe.


Viti	2011	2012	2013	2014
Gjithsej nxënës	1232	1792	1646	2175
Pikët	14116	53469	44512	48227
Përqindja	38.192 %	59.675 %	54.08 %	44.94 %



Parimet gjuhësore dhe letrare në korpusin e programeve të gjuhës dhe letërsisë...

Numri i nxënësve është shumë më i lartë në Gjinnazin “Hajdar Dushi “. Gjatë viteve 2011-2014 në testin e maturës shtetërore morën pjesë gjithsej 6818 maturantë të pesë shkollave gjedhe të hulumtimit tonë. Në tabelën më poshtë po paraqesim numrin e nxënësve sipas shkollave gjatë këtyre katër viteve.

Shkollat	Gjinnazi	Mjeksia	Ekonomia	Teknika	Gj.N.Kazazi
Nr. i nx.					
2011-2014	2473	1469	1479	851	546
Përqindja	36.276%	21.54%	21.69%	12.48%	8.00%



Përfundime

Duke analizuar dhe qëmtuar suksesin e maturantëve në lëndën e gjuhës shqipe në testet e maturës shtetërore për vitet 2011-2014 në pesë shkolla të qytetit të Gjakovës arrijmë në përfundimin se sukcesi më i dëshiruar rezulton në Gjinnazin “Hajdar Dushi”. Viti 2012 sipas hulumtimit tonë duket të jetë viti më i suksesshëm për të gjitha shkollat.

Por sa reale janë rezultatet e testeve të maturës, a kemi dominim të halo-efektit, kopjim, përdorimin e telefonave në kohën e mbajtjes së testit, ruajtja e anonimitetit të testeve deri në ditën e mbajtjes së provimit në tërë Republikën? Duke u bazuar në rezultatet e hulumtimit sukcesi në lëndën e gjuhës shqipe vetëm për vitin 2011 dhe 2014 del më i dobët, vetëm Gjinnazi ka arrirë 50 %- shin, ndërsa shkollat tjera jo.

Pas daljes së rezultateve të testit të maturës 2014 nxënësit më sukses të shkëlqyeshëm në lëndën e gjuhës, dhe në përgjithësi edhe në lëndët tjera nuk arritën të kalojnë testin në raundin e parë. Ndërsa si për çudi nxënësit me sukses të mjaftueshëm dhe të mirë, edhe pse jo në numër të madh kaluan testin e maturës shtetërore në raundin e parë.

Në vitin 2014 në tërë Republikën e Kosovës 46 mijë maturantë iu nënshtruan Provimit të Maturës Shtetërore. Testi u monitorua nga KALLXO.com falë një memorandumit të bashkëpunimit të nënshkruar ndërmjet MASHT dhe Internews Kosova/BIRN.

Po paraqesim disa nga parregullsitë të cilat monitoruesi KALLXO.com ka raportuar gjatë mbajtjes së Provimit.

Monitoruesi i KALLXO.com raporton se telefonat janë duke u marrë nga administratorët dhe po paktohen. Për dallim nga kjo qendër në Gjakovë në shkollën ekonomike “Kadri Kusari” monitoruesi i KALLXO.com raporton se telefonat nuk janë marrë, por ata po mbahen mbi bankën e secilit nxënës. Po ashtu monitoruesi në Kaçanik nga Gjimnazi “Skënder Beu” raporton se nxënësve nuk u janë marrë telefona. Ata po mbahen në xhepa dhe çantat e nxënësve.

Maturantët në Pejë thonë se do të përqendrohen në testin e tyre dhe nuk presin që të ketë përpjekje nga dikush prej bashkëmohatarëve për të kopjuar.

“Është ditë e stresit. Kam qenë nxënëse e shkëlqyeshme, mendoj se jam përgatitur”, thotë L. D. e cila sot do të testohet në sallën e sporteve “Karagaq”.

“Nuk kam kohë të shikoj te të tjerët, për shkak se duhet ta plotësoj testin tim”, thotë ajo.

Edhe një nxënës tjetër shpreson në mbarëvajtje të procesit.

“Do të kishte qenë shumë mirë të shkojë testi pa kopjim dhe ma merr mendja se do të ndodhë kjo”, thotë ai.

Fjalët më të shpeshta të maturantëve gjatë provimit sipas KALLXO.com ishin: “pyetja e 20, përgjigjja c...”, “cili opsion është tek pyetja 10-të...”, “hajde më shpejtë...”.

BIBLIOGRAFI

I. Hoti, *Gjuhësia e zbatuar dhe mësimdhënia e gjuhës*, UT, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Studime Albanologjike, Gjuhësi I, Tiranë, 2013.

J. Chateo -grup autorësh, *Pedagogët e mëdhenj, Libra për një shoqëri të hapur*, Toena, Tiranë, 2000.

M. Gjokutaj, *Didaktika e gjuhës shqipe, Shkronjë pas shkronje*, Ribotim, Tiranë, 2014.

Republika e Kosovës, MASHT, *Testi i Maturës*, Prishtinë, gusht 2008.

Republika e Kosovës, MASHT, *Testi i Maturës*, Prishtinë, qershor 2012.

www.telegraf.com